

MBËSHTETJE PËR GJUHËN STANDARDE NGA PETËR PRIFTI

Xhevat LLOSHI

Për veprimtarinë e gjithanshme të shqiptarit të shquar në SHBA, Petër Priftit (1924-2010), është e pamundur të shkruhet në pak faqe. Eleni Karamitri ka përgatitur artikullin përkatës në “Fjalorin Enciklopedik Shqiptar” (vëll. III, 2009) dhe e ka quajtur historian, gjuhëtar, publicist e përkthyes. Mua më bie të ndalem kryesisht në profilin e tij si kontribues për gjuhën shqipe. Në Bibliografinë e P. Priftit prej 30 faqesh, që e përgatiti mbesa e tij, Julika Prifti, janë renditur 7 shkrime nga fusha e historisë, por në të vërtetë ato janë shumë më tepër jo vetëm sepse këtu bëjnë pjesë edhe ato për besimet fetare, për kulturën, si dhe në botime të ndryshme, duke përfshirë edhe Enciklopedinë Britanike. Përveç kësaj dëshiroj të vë në dukje një anë tjetër. Është e dukshme që ky autor ka qenë gjallërisht i pranishëm në rrahjen e çështjeve shqiptare dhe ndërkombëtare me artikuj publicistikë, me fjalime, përkujtime, kritika letrare, recensionë, trajtesa politike, shoqërore dhe ekonomike, duke përfshirë në veçanti edhe problematikën e ngjarjet e Kosovës. Ndërkaq, tashti kam të drejtë ta cilësoj këtë trashëgimi të pasur se i përket historiografisë, në kuptimin që ajo është në vetvete një ndihmesë për të ndriçuar e shpjeguar rrjedhën e historisë shqiptare deri në shek. XXI.

Një shkrim i vitit 1995 në librin “Shqiptarët e Amerikës” (2003) mban titullin *Libri – jeta e tij. Me Petër R. Priftin në San Diego*. Ky titull nga Vehbi Bajrami në mënyrë të figurshme nënkupton, se nga njëra anë është jeta e tij si shqiptar në SHBA, dhe nga ana tjetër në oqeanin e pamatë të fjalës së shtypur.

Petri kishte lindur në Rehovë të Kolonjës, ndërsa vajti në Amerikë në moshën 15 vjeç, një e dhënë kjo me interes, sepse do të thotë që botën tashmë e kishte përvetësuar me gjuhën amtare, të cilën nuk ia cenoj periudha e gjatë prej shtatëdhjetë vjetësh në një mjedis si dygjuhësh. Të gjitha shkrimet e tij janë në një shqipe të pasur, të lëvruar, të hedhur në letër me kujdes të posaçëm. Sipas V. Bajramit, ai ka thënë: “Me zemër e shpirt kam ruajtur farën shqiptare, pasi jam brumosur me ajrin e vendlindjes”. Madje edhe kur hyri në Kolegjin e Pensilvanisë, mjedisi përreth i dukej si natyra e Kolonjës. U diplomua për filozofi më 1955 në Universitetin e Pensilvanisë, por kjo nuk e ndihmoi për jetesën e përditshme.

Ngaqë kishte filluar të bashkëpunonte me gazetën “Dielli”, e ftuan më 1958 të punonte si redaktor i gazetës në Boston, ku u njoh nga afër dhe me Fan Nolin. Edhe intervistën e parë e kishte bërë me Fan Nolin më 1958. Kështu jeta e tij mori një rrjedhë tjetër. Me Qamil Panaritin u bë edhe sekreetar i Federatës Panshqiptare “Vatra” (Më duhet të bëj një ndreqje për fjalët e V. Bajramit, sepse Petri nuk kishte mundësi të bashkëpunonte me motrat Qiriazit, të cilat botonin në SHBA revistën “Yll” i Mëngjesit”, ngaqë ajo ishte mbyllur dy vjet para se të lindte Petri, kursë më 1922 dy motrat hapën liceun për vajza në Tiranë). Petri e ka quajtur “Diellin” si regjistrin më të vjetër të jetës kolektive të shqiptarëve të Amerikës.

Pasi punoi për 15 vite në MIT (Massachusetts Institute of Technology) në Boston, u shpërngul më 1976 në San Diego Aty e ftuan të punonte si specialist i shqipes në Universitetin e Kalifornisë. Doli në profesion të lirë më 1990, duke pasur kështu mundësi t’i përkushtohet plotësisht vokacionit të tij. Deri më 1990 kishte dhënë ndihmesën e vet me disa vepra gjuhësore: Më 1979 së bashku me Leonard Newmark-un dhe Philip Hubbard-in përgatiti një antologji me tekste leximi për shqipen (*Readings in Albanian*, 3 vëllime, 1167 faqe). Arsyeja ishte se Petri e gjeti Njemarkun pikërisht në San Diego, ku ky kishte ardhur më parë dhe prej vitit 1965 ishte përgjegjës i Departamentit të gjuhësisë, të themeluar prej atij vetë. Më pas, duke u shtuar si

bashkautor dhe I. Haznedari, ribotuan librin për shqipen e folur (*Spoken Albanian*, New York, 348 f., botimi i parë nga Njumarku më 1954). Dhe dy vjet më pas, më 1982 të tre bashkautorët nxorën vëllimin Shqipja standarde (*Standard Albanian*, Stanford, 368 faqe). Autori i parë këtu ishte L. Njumarku (1929-2022), gjuhëtar amerikan, i cili ishte njohur me shqipen që më 1951, në një program të Universitetit të Indianës dhe kishte botuar më 1957 librin *Structural Grammar of Albanian*.

Titulli *Shqipja standarde* ishte më 1980 diçka e zakonshme për gjuhësinë amerikane, mjafton të përmendet autorja Janet Byron me librin e saj të vitit 1976 (*Selection among alternates...*), mirëpo në gjuhësinë shqiptare dikush e shihte si term të papërshtatshëm për të ashtuquajturën “gjuhë *sui generis*”. Përkundrazi, në këtë libër me bashkautor P. Prifrin jo vetëm përdoret termi anglisht, po edhe jepet karakterizimi i plotë i këtij varianti standard të shqipes. Është e pamundur të përkthej këtu gjithë faqet, që merren me karakterizimin e shqipes standarde në këtë vëllim, ndërsa e vlen ta vë në dukje, se kjo do të thotë që P. Prifti e njihte mirë këtë qëndrim ndaj shqipes së sotme dhe i përmbahej jo rastësisht. Për më tepër, pikërisht në këtë libër është përfshirë sythi i parë *Një skucë për vendin dhe popullin*, marrë nga libri i P. R. Priftit *Socialist Albania Since 1944: Domestic and Foreign Developments*, botuar dy vjet më parë. Skica hapet me këtë fjali: “Shqipëria ka emër si një vend me bukuri të madhe natyrore dhe me një të kaluar të largët romantike”.

Gjuhëtari amerikan V. A. Friedman e ka quajtur këtë libër “i pari libër mësimi i botuar në SHBA, që përdorte gjuhën shqipe standarde” (“Studimet albanistike në Amerikë”, Prishtinë, 2016, f. 42). Vetëm Rr. Paçarizi (po aty, f. 293) është përpjekur ta ulë vlerën e librit, meqë paska lënë pa trajtuar plot fenomene të shqipes si gjuhë, duke treguar kështu se nuk kishte kuptuar thelbin e veprës, e cila nuk i kushtohej shqipes si gjuhë, por vetëm variantit standard. Kjo qasje është mbi bazën e paragjytimeve krahinore, të cilat e shohin edhe gjuhësinë në prizmin jashtëshkencor. P. Prifti i pëmbahet tezës, se shqiptarët e kanë prejardhjen nga ilirët dhe se janë autoktonë. Ashtu si gjuha dhe vetë banorët, qytetet shqiptare janë dëshmi e lashtësisë së këtij vendi. Faqen më të shkëlqyer të historisë së tij e ka shkruar Skënderbeu. Rrethanat historike i mbrujtën shqiptarët me një frymë të fortë pavarësie dhe individualizmi, por ata janë të famshëm për mikpritjen e tyre. Ata ia kanë arritur të ruajnë gjuhën e tyre, kulturën dhe identitetin etnik. Edhe në vijimin nga L. Njumarku vihet në dukje se shqipja është një degë e veçantë e familjes indoeuropiane. Ndërsa pas Kongresit të drejtshkrimit: “Mundësia për të arritur të një gjuhë standarde me një shkallë njëformësie dialektore po aq të madhe sa edhe të gjuhët e tjera europiane duket tashti se është fare e afërt”.

Po gjuhësisë i përkasin recensionet e Priftit për gramatikën e M. Camajt (1984), për *Etimologjitë themelore të shqipes* nga M. E. Huld (1984). Mirëpo befas më 1989 Arshi Pipa botoi anglisht librin “Politika gjuhësore në Shqipërinë socialiste” (*The Politics of language in Socialist Albania*). Është një libër, që përbën një dukuri tronditëse, një sulm nga pozita të fanatizmit politik, kur një njeri i sulet si bishë një varianti të gjuhës së vet amtare. Ishte e natyrshme, që do të tërhiqte menjëherë vëmendjen e P. Priftit, sepse ishte në kundërshtim të hapur me pikëpamjet e tij, të mishëruara në punimet që preka më sipër. Prandaj në “South Slavic Journal”, nr. 3-4 1990 ai botoi recensionin anglisht *Një koment për kritikën e prof. Arshi Pipës ndaj shqipes letrare të njësuar* (*A commentary on prof. Pipa's critique of unified literary Albanian*). Pas një vështrimi të shkurtër historik, P. Prifti e ka quajtur Kongresin e Drejtshkrimit më 1972 “Një ngjarje si gur kilometrik në historinë e gjuhës shqipe”, ndërsa ai ishte fryt i punës së shumë brezave të studiuesve. Kurse faqet e librit të Pipës përshkohen nga zelli i kryqtarëve për betejat e kryqëzatave. Vetë gjuha e librit është plot me epitete goditëse pa e vrarë ndërgjegjja. Nuk ka argumente bindëse kundër gjuhës standarde, e cila është shumë e dëshirueshme, për të mos thënë e domosdoshme, si edhe për popujt e tjerë. Ajo e forcon ndërgjegjen kombëtare, mbështet arsimin dhe komunikimin, lehtëson marrëdhëniet dhe tregtinë në vend. Ishte pjekur koha për të pasur një gjuhë të tillë. Sidomos është zemëruar P. Prifti me pohimet e përbindshme të A. Pipës,

se toskët qenkan ortodoksë dhe kundër Perëndimit, madje qenkan bizantinë dhe kundër ilirëve, si dhe që në fund të fundit do të ketë një luftë ndërmjet Veriut e Jugut të Shqipërisë. Recensionin i fortë kritik mbyllet me mendimin e drejtë, se normat e gjuhës standarde nuk janë statike, por janë dinamike dhe të hapura për ndryshime. Si një organizëm i gjallë, gjuha letrare pëson dhe do të pësojë ndryshime.

Arshi Pipa nuk mund ta shpërfillte kritikën e Priftit, se e njihnin gjithë shqiptarët e Amerikës (po e ka bërë me punimin tim). Në numrin 3-4 të revistës “Albaniaca”, 1992 e ribotoi recensionin, por e shoqëroi me një “Koment” gegërisht (f. 163-164). Është një orvatje qesharake me arsyetime qesharake, deri aty, sa ta quajë gjuhën shqipe letrare të fabrikuar sipas një recete të Stalinit, e përfundimisht duke e cilësuar vetë Petrin se e ka “radhitë veten në kampin stalinist”. Nuk do të citoj këtu shumë e shumë libra të Priftit, në të cilët është krejt i qartë qëndrimi i tij ndaj diktaturës staliniste në Shqipëri, prandaj po sjell vetëm një titull *Albania Communist States in Disarray* (1972), që shqip do të thotë shteti komunist në zallamahi. Me po atë gjuhë të ulët, Pipa e ka quajtur Priftin se e radhit veten “me pseudoshkencëtarët marristë shqiptarë”. Por edhe kjo është pak për të vërtetuar degjenerimin e A. Pipës, i cili katandiset deri aty, sa të thotë që: “prej shekullit të dytë mb. Krishtit te shekulli i njëmbëdhjetë, shqiptarët nuk dalin në histori dhe, kur dalin, përmenden si nomadë, po ashtu si aromunët”.

Edhe pasi u njoh me realitetin gjuhësor në Shqipëri, Arshi Pipa nuk hoqi dorë nga agresiviteti i vet i papërligjur. Më 1995 ka dhënë një intervistë, në të cilën sipas tij “Gjuha e njësuar është bërë pa baza shkencore, fatkeqësisht në baza imorale”. (Intervistë ekskluzive e profesor Arshi Pipës, në: “Java”, Prishtinë, 13 korrik 1995).

Kur më ra në dorë ai libër ogurzi, e pashë të nevojshme t’i kundërvihesha pa asnjë lëshim. Botova një punim të gjatë me titullin *Kultura shqiptare përpara shqetësimesh të reja – Rrehe librit të Arshi Pipës “Politika gjuhësore në Shqipërinë socialiste”*. Pasi doli në revistën “Sot” më 1991 (nr.5-6, faqe 5-29), u ribotua me vijim në gazetën “Bujku” të Prishtinës në 4, 6-9 shkurt 1992 dhe me vijim në revistën “The Voice of Truth” në Ringfield, New Jersey, USA, 1993, vëll. 6, nr. 1, qershor, f. 1-14. Më pas e kam ribotuar në librin *Mbështetje për gjuhën letrare*, Tiranë, 1997, f. 3-52. Nuk do të përsëris gjithçka e kam trajtuar me argumente shkencore e historike për ta hedhur përdhe sajësën e shëmtuar të A. Pipës, por do të më lejohet të citoj çfarë kam shkruar tashmë 35 vjet më parë lidhur me P. Priftin:

“Sa për gramatikën e gjuhës shqipe [nga Instituti i Gjuhësisë e i Letërsisë], mbi bazën e saj dhe pjesërisht duke e përkthyer atë, është hartuar dhe botuar anglisht një libër i madh nga Universiteti i Stanfordit, Kaliforni, SHBA, me titullin “Standard Albanian” (1982, 347 faqe). Autorë janë profesori Leonard Newmark, i cili po përgatit tani një fjalor shqip-anglisht, Philip Hubbard, profesor i gjuhësisë në Universitetin e San Diegos, dhe Peter Prifti gjithashtu në Universitetin e Kalifornisë. Lexuesit do të më lejojnë në këtë ribotim të shtoj një shënim. Profesori Peter Prifti kishte përgatitur një recension për librin e Arshi Pipës që më 1990 me titullin anglisht A Commentary on Prof. Pipa’s Critique of United Literary Albanian, për revistën “The South Slavonic Journal”, Londër, vëll. 13, nr-3-4, vjeshtë-dimër 1990, por që doli nga shtypi me vonesë në vjeshtë 1992. Recensionin është botuar shqip më 1995 me titullin Gjuha letrare është organizëm i gjallë... Një punim të P. Priftit e ka futur në bibliografinë e vet A. Pipa, por librin e madh nuk e ka përmendur fare, sepse ekzistenca e kësaj vepre dhe parathënia e saj i hedhin në erë gjithë pohimet e A. Pipës. Për të plotësuar kureshtjen e lexuesve tanë, po përkthej pak rreshta të parathënies anglisht në veprën kolektive të vitit 1982: “Që nga Lufta e Dytë Botërore janë bërë mjaft përpjekje në Shqipëri – që kanë gjetur mbështetjen e folësve të shqipes edhe në vendet e tjera – për t’u marrë vesh për një variant të vetëm të gjuhës, që të shërbejë si gjuhë standarde e vendit dhe këto përpjekje kanë pasur një sukses të shënuar, nëse gjykojmë nga përpjekjet e folësve të shqipes në Shqipëri dhe jashtë saj për t’i zbatuar normat e caktuara”. (f. 6). Tërheqim vëmendjen e lexuesve, se për këtë parathënie lënda është marrë pikërisht nga punimi i P. Priftit, që e ka cituar A. Pipa, pra nuk mund të thuhet se nuk e

njihte. Kështu, mungesa e përmendjes së librit të madh Standard Albanian nuk është e rastit, por e qëllimshme”.

Siç shihet, recensionin e Petër Priftit është botuar edhe shqip në revistën “Gjuha shqipe”, e cila ka mbetur i vetmi organ që vijon të botohet për kulturën e gjuhës shqipe. Më duhet të bëj një plotësim, sepse profesori Hubbard ishte në Universitetin e Stanfordit, Qendra e gjuhës, drejtor i anglishtes për të huajt, specialist në mësimin e gjuhëve me ndihmën e kompjuterit, ndërsa si tezë doktrate kishte pasur më 1980 sintaksën e togfjalëshit të foljes në shqipen.

Ndonëse krijimtaria e Peter Priftit është shtrirë në shumë fusha të tjera, që zënë vendin më të gjerë, ai nuk ka munguar t’i drejtohet gjuhësisë edhe në raste të tjera pas vitit 1990. Në dy numra të revistës “Gjuha jonë”, më 1997 dhe 1998 është botuar punimi i tij i gjatë “Mësimi i shqipes në Shtetet e Bashkuara të Amerikës”. Pa hyrë në përsëritjen e përmbajtjes së këtyre njoftimeve të vlefshme, po citoj vetëm dy radhët e para të Hyrjes: “Për shqiptarët gjuha është pasqyra ku ata shohin veten e tyre më së miri si pjesëtarë të një kombi. Në dhe të huaj ajo është karta kryesore e identitetit të tyre si njerëz të familjes shqiptare, me tiparet e saj të veçanta. Është mekanizmi më i fuqishëm për transmetimin e trashëgimit kulturor nga prindët te fëmijët”. Diçka me interes të veçantë në këtë punim është Bibliografia, në të cilën janë renditur veprat e cituara më sipër, si dhe të studiuesve amerikanë për shqipen. Ky punim është ribotuar disa herë. Me të shkon edhe artikulli “Mësimi i shqipes në Universitetin e Kolumbjes” në gazetën “Illyria”, nëntor 2000. Së fundi, një recension i ka bërë librit të gjuhëtarit tonë të njohur, Shaban Demiraj, me titullin “Prejardhja e shqiptarëve nën dritën e dëshmimeve të gjuhës shqipe” (1999) te “Zëri i së vërtetës”, dhjetor 2001.

Po të përmbledhet kjo pjesë e trashëgimisë së P. Priftit, shihet se ai i ka kushtuar vëmendje të posaçme gjuhës shqipe si gjuhëtar, si lëvrues i shqipes, si historian i gjendjes së saj në SHBA, por kryesorja është se e ka bërë këtë kurdoherë me dashuri të thellë për gjuhën e mëmës dhe me dëshirën që ajo të shfaqet e lëvruar dhe e pasur jo vetëm për bashkatdhetarët e tij, por edhe për opinionin shkencor ndërkombëtar.